Sigurimi i jetës dhe shëndetit nga SiCRED, një zgjidhje e mençur për mbrojtje financiare në rast të papritura, si dhe kompensim dhe kursim për shpenzimet mjekësore

Duke filluar me vetëm 7 euro në muaj me SiCRED, sigurimi i jetës së individit dhe përballimi i shpenzimeve shëndetësore private nuk është më luks

Pak kulturë për sigurimin e jetës dhe shëndetit

Sigurimi i jetës dhe shëndetit, është një kontratë sigurimi midis individit dhe kompanisë së sigurimit, e cila i garanton të siguruarit kompensime dhe përfitime në rast se personi pëson aksidente, sëmundje si dhe ofron një mbështetje financiare për pasardhësit në rast humbje jete të të siguruarit.

Edhe pse është vështirë të mendojmë për rastet fatkeqe, secili prej nesh përballet me pyetjet: çfarë do të ndodh me mua nëse sëmurem apo pësoj një aksident? A do të mundem unë apo familja ime të përballojmë kurimin tim? Çfarë do të ndodh me familjen time, nëse papritur largohem nga kjo jetë? Kush do kujdeset për fëmijët? A do kenë para mjaftueshëm për të ngrënë, për t'u veshur, për t'u shkolluar, etj.?

Të ndodhur përballë një rreziku që cënon seriozisht jetën e një personi të dashur, familjarët do sakrifikonin gjithçka që munden për të siguruar burimet financiare për kurimin e për ta mbajtur personin në jetë deri në shpresën e fundit. Shpenzimet në raste të tilla shpesh janë aq të larta, sa ato në vijim transformojnë tërësisht jetën e familjarëve, që ndoshta do iu duhet të shlyejnë edhe borxhe të shumta.

Kujdesi ndaj vetes përfshin një tërësi veprimesh që një person duhet të ketë në vëmendje për të gëzuar një jetë të lumtur. Një nga shqetësimet më të mëdha është të gëzuarit e një shëndeti të mirë, pasi siç thonë: nëse je mirë me shëndet, ka një zgjidhje për çdo gjë tjetër! Një shëndet i mirë nënkupton jo vetëm të mos pasurit të sëmundjeve, por nënkupton të pasurit nën kontroll të çdo gjëje që ndodh në trupin tonë. Kontrollet periodike parandaluese, të cilat në vendet e tjera europiane janë më se të zakonshme, në Shqipëri janë ende larg mendësinë që kemi trashëguar prej vitesh tashmë, e që te mjeku shkojmë vetëm për t'u kuruar. Kurimi në vend të parandalimit, është produkt i një sërë faktorësh, si: aksesi në shërbimet mjekësore, kultura familjare, niveli i edukimit, mundësitë financiare, etj.

Planifikimet që bëhen dhe vendimet që merren sot, i kursejnë çdo individi një sërë problemesh dhe shqetësimesh në të ardhmen. Të treguarit kujdes ndaj të papriturave jetësore dhe shëndetësore me të cilat mund të përballesh nesër, tregon maturitet, vizion për të ardhmen, si dhe përkujdesje dhe dashuri për familjen.

Sigurimi i Jetës dhe Shëndetit në Shqipëri

Sigurimi privat i jetës dhe shëndetit në Shqipëri mendohet si luks, por në fakt ai është një domosdoshmëri për çdo familje dhe duhet të jetë pjesë e pandashme e planit financiar të saj! Humbja e një personi të dashur është e pazëvendësueshme, por rasti bëhet edhe më fatkeq nëse ky person ka qenë burimi kryesor i të ardhurave në familje. Sigurimi i jetës garanton të ardhmen financiare të familjes, në rast fatkeqësie jetësore, e megjithatë interesi dhe kujdesi që tregojnë qytetarët shqiptar për sigurimin e jetës mbetet ende larg standardit. Në periudhën 2011 - 2014 një person në Shqipëri ka shpenzuar afërsisht 2 euro në vit për sigurimin e jetës dhe më pak se 4% e popullsisë në moshë pune[1] kanë një kontratë sigurimi jete.

Të dhënat nga INSTAT dhe nga Instituti i Shëndetit Publik, tregojnë që në periudhën 2011 - 2014, një person në Shqipëri ka shpenzuar afërsisht 80 - 90 euro[2] në vit për shpenzime shëndetësore (blerje ilaçe, vizita, analiza, etj.). Shqiptarët paguajnë nga xhepi për marrjen e shërbimeve shëndetësore private, ndërsa shërbimet shëndetësore që merren nëpërmjet shoqërive të sigurimit janë të papërfillshme në krahasim me totalin e shpenzimeve shëndetësore.

Duke parë shifrat e mësipërme me pagesat që qytetarët shqiptarë realizojnë, fare mirë mund të blejnë paketa sigurimi jete dhe shëndeti privat dhe të kenë mundësi të përfitojnë shërbime dhe mbulime të larta në shoqëritë e sigurimit.

Zhvillimi i sektorit të sigurimit privat të jetës dhe të shëndetit, stimulon në të njëjtën kohë zhvillimin e sektorit privat të ofrimit të shërbimeve shëndetësore, duke rritur aktivitetin e këtij sektori, duke stimuluar dhe nxitur ofrimin e shërbimeve më cilësore, duke nxitur konkurrencën brenda sektorit dhe duke e bërë atë më atraktiv për investitorë të rinj.

Shqipëria, e fundit në rajon për sigurimin e jetës dhe shëndetit

Densiteti i primit (primi për frymë në vit) për sigurimin e jetës dhe shëndetit në Europë ndryshon sipas rajoneve. Në vendet e Bashkimit Europian në periudhën 2011-2014, densiteti i primit vjetor të sigurimit të jetës ka qenë 1100 euro dhe densiteti i primit të sigurimit të shëndetit ka qenë 200 euro. Ndryshe paraqitet situata në vendet e Ballkanit dhe Europës Juglindore ku primi për frymë po në këtë periudhë për jetën ka qenë mesatarisht 56 euro në vit, e ndërsa në Shqipëri ka qenë vetëm 2 euro në vit. Për sigurimin e shëndetit, në Bashkimin Europian shpenzohet mesatarisht 200 euro në vit për frymë, në Ballkan mesatarisht 24 euro për frymë, ndërsa në Shqipëri më pak se 1 euro në vit për frymë.

Grafiku më sipër, tregon primin e sigurimit të jetës për frymë dhe primin për sigurimin e shëndetit në disa nga vendet e rajonit e përllogaritur si mesatare në periudhën 2011 - 2014.

[1] Përllogaritur si raport midis numrit të kontratave të lidhura sipas raportimit të Buletinit statistikor të AMF me numrin e popullsisë në grupmoshën 15-69 vjeç.
[2] http://www.ishp.gov.al/wp-content/uploads/2015/materiale/Raporti-shendetesor.pdf
http://www.instat.gov.al/media/309688/abf_2014_final_16_09_2015_18_34.pdf

Shoqëria e Sigurimit të Jetës SiCRED sh.a. ofron për të gjitha familjet paketat e sigurimit "Jetë dhe Shëndet Cash Plan", të përshtatura për nevojat dhe kërkesat e individëve dhe me çmime të favorshme. Me sigurimin privat të jetës dhe shëndetit, i siguruari garanton për familjen e tij mbrojtje financiare në rast humbje jete, njëkohësisht siguron dhe shëndetin e tij duke patur një burim të ardhurash për mbulimin e shpenzimeve mjekësore.

Disa nga arsyet pse rekomandojmë sigurimin "Jetë dhe Shëndet Cash Plan" për ju dhe familjen tuaj, janë:

1. Mbrojtje dhe siguri financiare për familjen tuaj. Në rast fatkeqësie (humbje jete për shkak sëmundje apo aksidenti) familja do të ketë një mbështetje financiare, duke përfituar nga kjo policë sigurimi shumën e sigurimit të jetës së personit të siguruar.
2. Kontrolloni më mirë financat tuaja. Nuk është e nevojshme që ju të rezervoni një shumë parash e ta mbani të bllokuar për të papriturat jetësore dhe shëndetësore. Polica e sigurimit i përgjigjet më së miri të papriturave të tilla.
3. Një zgjidhje e kompletuar për shëndetin tuaj. Ky produkt sigurimi ofron mbulim të shpenzimeve mjekësore për çdo shkak (kontrolle diagnostikuese, sëmundje, aksident, etj.), shpenzime për ndërhyrje kirurgjikale me shtrim dhe pa shtrim, vizita doktori, ekzaminime mjekësore, ilaçe, etj.
4. Mbani në kontroll të vazhdueshëm shëndetin tuaj. Sigurimi ofron një paketë të plotë me ekzaminime mjekësore të kujdesit parandalues.
5. Keni të drejtë të merrni shërbime mjekësore në të gjithë rrjetin mjekësor me të cilin SiCRED bashkëpunon në Shqipëri dhe jashtë vendit, në mbi 60 klinika dhe spitale private, duke përfituar trajtim preferencial dhe zbritje nga çmimet e shërbimeve nëpërmjet kartës së sigurimit.
6. Përkujdesjen dhe asistencën e pakufizuar të një ekipi profesional, të specializuar në sigurimin e jetës dhe shëndetit, i cili është në dispozicionin 7 ditë të javës.

Sa më herët të siguroheni, aq më mirë është! Me paratë që shpenzoni familjarisht çdo vit për shëndetësinë, mund të blini një sigurim privat jete dhe shëndeti, duke siguruar jetën tuaj dhe njëkohësisht duke përfituar shumë më shumë shërbime se çfarë merrni aktualisht, e duke i ofruar vetes shërbime mjekësore në kohë, dinjitoze dhe me cilësinë dhe standardet bashkëkohore.

Zgjidhja që ju ofron SiCRED!

SiCRED ofron 8 Paketa të ndryshme për Sigurimin e "Jetës dhe Shëndetit Cash Plan" të cilat ofrojnë mbulimet dhe përfitimet si vijon:

OPSIONET E SIGURIMIT "JETË DHE SHËNDET CASH PLAN"	OPSIONI 1	OPSIONI 2	OPSIONI 3	OPSIONI 4	OPSIONI 5	OPSIONI 6	OPSIONI 7	OPSIONI 8
Territori i Mbulimit:								
- Shqipëri	✓	✓	✓					
- Europë (përjashtuar Zvicër)				✓	✓	✓	✓	✓
Shuma Maksimale e Sigurimit	2,000 Euro	5,000 Euro	10,000 Euro	10,000 Euro	15,000 Euro	25,000 Euro	25,000 Euro	25,000 Euro
Përfitim për Sigurim Jete	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Mbulimet e Shëndetit:								
- Checkup Vjetor	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
- Vendi për kryerjen e Checkup	Shqipëri	Shqipëri	Shqipëri	Shqipëri	Shqipëri	Shqipëri	Itali	Austri
- Mbulim të shpenzimeve mjekësore në rast sëmundje dhe aksidenti	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
- Përfitim për analiza, medikamente, vizita mjekësore, etj.	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
- Përfitim për ndërhyrje me shtrim	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
- Përfitim për ndërhyrje pa shtrim	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
- Kimioterapi dhe Radioterapi	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Sigurim i Shëndetit në Udhëtim (Europë):					✓	✓	✓	✓
- Trajtim Urgjent					✓	✓	✓	✓
- Evakuim/Riatdhesim					✓	✓	✓	✓